

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAV ARUR
Per Fondet e perfituara dhe shpenzuara
Viti fiskal qe perfundon me 31 Dhjetor 2015

PER

PARTIA BALLI KOMBETAR DEMOKRAT
Adresa Rr. Muhamet Gjollesha, nr. 168– Tirane

EKR. LEFTERI KUSHTA



Tirane, 31 tetor 2016

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVAU

Drejtuar : Komisionit Qendror te Zgjedhjeve, Rr.Ibrahim Rugova, Nr.4, Tiranë, Shqipëri,

Partia e Ballit Kombetar Demokrat (Rr. M.Gjolleasha nr.168) Tirane

Te Nderuar Zoterinj:

Me cilesine e EKR, bazuar ne vendimin nr. 126 Dt. 20.09.2016 te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve, kam audituar pasqyrat qe lidhen me te ardhurat e perfituara dhe shpenzuara per vitin 2015 te Partise Balli Kombetar Demokrat.

Pergatitja e ketyre pasqyrave mbi bazen e parimit te arketimeve dhe pagesave , eshte pergjegjesi e Partise Balli Kombetar Demokrat e cila eshte pergjegjese per pergatitjen dhe paraqitjen ne menyre te sinqertë të këtyre pasqyrave në përputhje me ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr.8580, dt.17.02.2001 “Për partitë politike” i ndryshuar dhe ligjin nr.9228 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë 29.09.2004.

Përgjegjësia jonë është që bazuar në auditimin e kryer, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Auditimin e kemi kryer në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit, referencë të veçantë me SNA 800.

Këto standarte kërkojnë që ne të planifikojme dhe të kryejme auditimin per te zoteruar siguri te arsyeshme se keto pasqyra nuk permbajne anomali materiale. Auditimi perfshin ekzaminimin, mbi bazen e testeve, te evidences qe mbeshtet shumat dhe informacionet e dhena ne pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit te audituesit, duke perfshire vleresimin e rreziqeve per anomali materiale ne pasqyrat financiare, qofte per shkak te mashtrimit ose te gabimit. Ne berjen e ketyre vlersimeve te rrezikut, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem perkates te shoqerise ne pergatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave financiare ne menyre qe te hartoje procedurat e auditimit qe jane te pershtatshme per rrethanat

Auditimi perfshin gjithashtu, vleresimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Në çmujmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme, për të dhënë një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, bazuar në auditimin e kryer, me siguri të arsyeshme, shprehim opinionin se Pasqyrat Financiare të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara, për Vitin kalendarik 2015, janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit mbi bazën e arketimeve dhe pagesave,



konform ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Ligjit nr.8580, dt.17.02.2001 “Për partitë politike”, i ndryshuar duke dhënë **një pamje të vërtetë dhe të sinqertë.**

Lefteri Kushta



Ekspert Kontabël I Regjistruar

Lic. 58 date 31.01.2000

Tirane, me 8.11. 2016



SHENIME PLOTESUESE NE LIDHJE ME AUDITIMIN E PARTISE BALLI KOMBETAR DEMOKRAT

PER FONDET E PERFITUARA DHE TE SHPENZUARA PER VITIN 2015

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Baza ligjore per kryerjen e ketij misioni është marrë në referim të ligjeve:

- Ligji nr.8580, dt.17.02.2001 “Për partitë politike”, i ndryshuar.
- Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”,
- Standartet Ndërkombetare të auditimit dhe kryesisht (SNA 800).
- Ligji Nr. 9228 date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”
- Çdo dokument ligjor të marrë prane Partisë BALLI KOMBETAR DEMOKRAT.
- Vendimi Nr.126 date 20.09.2016 i Komisionit Qendror te Zgjedhjeve

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Partia BALLI KOMBETAR DEMOKRAT e regjistruar me Vendim te Gjykeses Rrethit Tirane nr. 33/1 date 25.09.1998 dhe 12700 date 21.12.2012,eshte krijuar sipas dispozitive perkatese te Ligjit nr. 8580, dt.17.02.2001 “Per Partitë Politike”, të Ligjit nr.8788, dt.07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimpruese “, të Ligjit nr.8779, dt.07.05.2001 “Për Regjistrimi e Organizatave Jofitimpruese”.Ajo funksionon ne perputhje me statutin e saj dhe legjiacionin ne fuqi.

Kryetar i saj eshte Artur Roshi i cili është i autorizuar të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për aktivitetin normal të partise.

Subjekti eshte rregjistruar ne Drejtorine Rajonale Tatimeve Tirane me nipt L51903451H.

Subjekti zgjedhor Partia “BALLI KOMBETAR DEMOKRAT” është një bashkim politik i qytetarëve shqiptarë e cila e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë. Qendra e Partisë “BALLI KOMBETAR DEMOKRAT” është në Tiranë, rruga “M. Gjolllesha ”nr 168.

Burimet e financimit te Partise jane:

- Te ardhurat nga fondet publike (KQZ);
- Ndihmat dhe dhuratat e antaresise dhe te perkrahesve te Partise;
- Çdo e ardhur tjetere qe nuk bie ne kundershtrim me ligjislacionin per financimin e partive politike.

MËNYRA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare janë përgatitur, në përputhje me Normat Kombëtare të Raportimit Financiar (NKRF), të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin nr.9228 dt. 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare“ ne baze te parimit te arketim pageses.

Rregullat e vlerësimit të likuiditeteve

Gjendjet e likuiditeteve përfshijne gjendjen e parave në arkë dhe në llogaritë rrjedhese në bankë në leke. U kontrolluan veprimet e kryera në arkë dhe bankë dhe u konstatuan se regjistrimet në librat e llogarive dhe në ditarët përkatës ishin kryer sipas normave kontabël.

Organizimi i Kontabilitetit

Kontabiliteti është i organizuar në përputhje me ligjin “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare” sipas parimit të arketim pagesave. Kontabiliteti mbahet në menyre manuale.

PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

A-

- Te ardhura te perfituara nga Fondet Publike ne shumen 650.220 Leke ,
 - Te ardhura te tjera (mjete te trasheguara ne llogari) ne Shumen 7.431 Leke,
- Nuk ka te ardhura te tjera nga kuotizacionet dhe nuk ka asnje donacion te cfardo lloji.

B. Te shpenzuara ne shumen 616.401 Leke , si me poshte :

- materiale zgjedhore, shtypshkrime e kancelari	424.230 leke
- Karburant	149.800 leke
- Mirembajtje e riparime	10.000 leke
-Post telefon	14.680 leke
-Pritje peregjellje	1.290 leke
-kthim fonde nga te ardhurat publike	12.764 leke
-komisione bankare	3.637 leke

Shpenzimet jane te dokumentuara me dokumente pergjithsisht te rregullt fiskale.

C, Shuma te mbetura ne llogari 41.250 Leke

Shumat e mesiperme si per te ardhurat e perfituara dhe te shpenzuara, per vitin 2015 konfirmohen edhe nga Pasqyra e Shpenzimeve dhe te ardhurave te dorzuar ne KQZ sipas detyrimit ligjor dhe te audituara nga auditi i fushates zgjedhore.

Gjendja e Likuiditeteve :

Ne mbyllje te vitit gjendja e likuiditeve ne llogarite bankare dhe arke eshte 41.250 leke dhe perputhet me gjendjet ne librat kontaabel.

Ngjarje te mevonshme Nuk ka patur ngjarje te mevonshme qe mund te influencojne ne pasqyrat financiare te mesiperme.

Lefteri KUSHTA Eksperte Kontabël e Regjistruar Lic. Nr.58

Tirane, 31 tetor 2016



A- PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

(Bazuar në klasifikimin e Shpenzimeve sipas Natyrës)

	Përshkrimi i Elementëve	Shënime	Viti raportues 31.12.2015	Viti paraardhës 31.12.2014
I	Te Ardhurat		657,651	
1	Fonde publike	11	650,220	
2	Dhurime nga pers. fizik (te pa dekl. ne fushat. zgjedh.)			
3	Dhurime nga pers. jurid (te pa dekl. ne fushat. zgjedh.)			
4	Kuota te antaresise			
5	Nga veprimt ekonomike			
6	Te Ardh te tjera Financiare (qera interesa etj)		7,431	
	Mjete te trashguara nw llogari		7,431	
	Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat 767, 667		-	
	Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi 769, 669			
	Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668			
III	Shpenzimet.		616,401	
1	Materialet dhe mallrat e konsumuara	11		
2	Kosto e punës	11	-	-
	Pagat e personelit		-	
	Shpenzimet per sigurimet shoqër. dhe shënd.		-	
3	Amortizimet dhe zhvlerësimet		-	
4	Shpenzime të tjera		612,764	
	Kthim fondi nga te ardh e fondeve publike		12,764	
	Mteriale zgjedhore, shtypshkrime e kancelari		424,230	
	Karburant		149,800	
	Mirimb e riparime		10,000	
	Post telefon		14,680	
	Pritje percjellje, Udhetim e dieta		1,290	
5	Shpenzime financiare		3,637	-
	Komisione bankare	0	3,637	
	Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat 767, 667	0		
	Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi 769, 669	0	-	-
	Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668	0		
	Diferenca(Ardh - Shpenzime)		41,250	



PARTIA BALLI KOMBETAR DEMOKRAT
NIUS: L51903451H

Pasqyra e fluksit monetar – Metoda indirekte	Shenime	Viti raportues 31.12.2015	Viti paraardhës 31.12.2014
<u>Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit</u>			
Grantet dhe te hyrat		0	
Rregullime për:			
Amortizimin		0	
Humbje nga këmbimet valutore		0	
Të ardhura nga investimet			
Shpenzime për interesa		0	
Rritje/rënie në tepricën e kërkesave të arkëtueshme në		0	
Rritje/rënie në tepricën inventarit		0	
Rritje/rënie në tepricën e detyrimeve, për t'u paguar nga aktivitetet		33,819	
Mjete monetare të përfituara nga aktivitetet		33,819	
Interesi i paguar			
<u>Mjete monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit</u>		33,819	
<u>Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese</u>			
Blerja e shoqërisë së kontrolluar X minus paratë e arkëtuara		0	
Blerja e aktiveve afatgjata materiale			
Të ardhura nga shitja e pajisjeve		0	
Interesi i arkëtuar		0	
Dividendët e arkëtuar			
<u>Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet investuese</u>		0	
<u>Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare</u>			
Hyrje nga emetimi i kapitalit aksioner		0	
Hyrje nga huamarrje afatgjata		0	
Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare		0	
Dividendët e paguar			
<u>Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet financiare</u>		0	0
<u>Rritja/rënia neto e mjeteve monetare</u>		33,819	7,431
<u>Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël</u>		7,431	
<u>Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël</u>		41,250	7,431

Kontrolli	OK	OK
Diferenca	-	-
Duhet te jetë	33,819	7,431